



ALBGAS sh.a.

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR

ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISË

Nr. _____ Prot

Tiranë, më 28/3/2024

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË

2024

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGAS Sh.a.**



ALBGAS Sh.a

Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror

Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovarëve,

Pallati Ndër Pro, Tiranë, Shqipëri

www.albgaz.al

NUIS: L71306034U



RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË PËR VITIN 2024

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGaz Sh.a.**

Tiranë, 2024

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2024

Ky raport është përgatitur në bazë të informacionit që është vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror ALBGAZ Sh.a., Zyrtarit të Përputhshmërisë së Shoqërisë gjatë përmbushjes së përgjegjësisë së tij në vitin 2024.

Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe vendimit të ERE Nr. 171, Datë 16.08.2022 mbi “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAZ” sh.a”, raporti vjetor do të publikohet në dy gjuhë në faqen zyrtare të internetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Gazit - ALBGAZ Sh.a (www.albgaz.al) brenda pesë ditëve nga paraqitja e tij në gjuhën shqipe Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Raporti duhet të ketë përfunduar deri më 31 mars të çdo viti.

Përgatiti:

Elvis Ponari MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë

Email: elvis.ponari@gmail.com

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME

ALBGAZ sh.a: Operatori i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Nat.

ALBPETROL sh.a: Shoqëria publike e kërkimit Prodhimit të Naftës dhe Gazit

ERE: “Enti Rregullator i Energjisë”

OSSH/DSO: “Operator i Sistemit të Shpërndarjes”

ALBGAZ/TSO: “Operator i Sistemit të Transmetimit”

ENTSO-G: është Rrjeti European i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit (observer)

MIE: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

GNL: “Gaz Natyror i Lëngshëm”

MEDREG: Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut

ECRB: Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Energjisë

ACER: Agjencia për kooperim e rregullatorëve të energjisë për Europën.

CEER: Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë

GRI SSE: Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje

IGU: Unioni Ndërkombëtar i Gazit, jemi anëtarë me të drejta të plota

OME: Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë

UfM: Unioni për Mesdheun

ALPEX: Bursa Shqiptare të Energjisë.

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË	6
1. Hyrje.....	6
2. Shoqëria	6
3. Vështrim i Përgjithshëm mbi ALBGAZ, licencim dhe aktivitete	7
4. Programi i Përputhshmërisë.....	8
A. Ndarja dhe pavarësia.....	9
1. Ndarja.....	9
2. Pavarësia drejtuese.....	9
3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse	10
B. Përfshirja e sjelljes diskriminuese.....	10
1. Aksesimi në sistemin e transmetimit	10
2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale.....	11
3. Konflikti i interesit.....	11
C. Politika e informacionit të kompanisë ALBGAZ.....	12
1. Sigurimi i informacionit	12
2. Konfidencialiteti i informacionit	12
3. Informacioni publik.....	12
D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë.....	12
PJESA E DYTË	14
4. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë	14
PJESA E KATËRT	15
6. Konkluzione.....	15

PJESA E PARË

1. Hyrje

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 178, datë 15.10.2015),), në zbatim të kërkesave të Programit të Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror. Gjithashtu në mbështetje të nenit 21 të Direktivës 2009/72/EC e datës 13 Korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC” u hartua ky raport. Raporti vjetor u hartua në bazë të detyrave të Zyrtarit të Përputhshmërisë, Z. Elvis Ponari MBA, MSc (Zyrtari), miratuar me Vendimin paraprak ERE Nr. 355, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së Albgaz sh.a dhe vendimi nr. 3 datë 01.02.2024 nga Këshilli Mbikëqyrës i Albgaz sh.a “Emërimin e zyrtarit të përputhshmërisë të shoqërisë Albgaz Sh.a”, Ky raport vjetor i Përputhshmërisë që hartohet për herë të pestë si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të shoqërisë “ALBGAS” sh.a. (ALBGAS) në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të ALBGAS në lidhje me këtë Program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar për herë të parë në 2020 nga Këshilli Mbikëqyrës i ALBGAS me vendim Nr.18, datë 04.11.2020 mbi “miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, miratuar në ERE me vendim nr. 263, datë 28.12.2020. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a”.

Programi nxjerr një Raport vjetor, i cili bazohet në sigurimin e shmangies së sjelljeve diskriminuese të ALBGAS ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror dhe përdoruesve të rrjetit, pavarësisë së ALBGAS, konfidencialitetin e të gjithë informacionit të menaxhuar nga ALBGAS si dhe transparencës së procedurave të ndjekura prej saj përgjatë periudhës 1.1.2024 – 31.12.2024.

Zyrtari konstantoi që ALBGAS është në përputhje me standartet e industrisë, ligjet, rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga ERE. Zyrtari gjatë vitit 2022 e analizoj kompaninë sipas Programit dhe ushtroi detyrën e tij që Programi të zbatohet nga shoqëria. Gjithashtu përgjatë 2022 Zyrtari është kujdesur që kompani të respektoj dhe rregulloret ndërkombëtare. Për të përmbushur çdo kërkesë për përputhshmërinë, Zyrtari sëbashku me ALBGAS kanë bashkëpunuar për të krijuar rregullore, udhëzime, trajnime, prezantime, dhe procese në mënyrë aktive në mënyrë që shoqëria dhe stafi i saj të jetë sa më në përputhshmëri me Programin.

2. Shoqëria

ALBGAS është një shoqëri aksionare me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti me aksionar të vetëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAS” sh.a. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës. Gjithashtu shoqëria ka një zyrë përfaqësimi në qytetin e Fierit.

Përgjatë kësaj periudhe, ALBGAS i ka bërë me dije Entit Rregullator të Energjisë se ka marrë të gjitha masat dhe aktualisht jemi në proces konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje. Gjithashtu, duhet theksuar se shoqëria është në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, në të cilën MIE ka një rol kyç jo vetëm si institucioni përgjegjës për politikën e zhvillimit të sektorit të gazit natyror, por edhe të mbikëqyrjes së ecurisë së projekteve të zhvillimit dhe të ndërtimit të sistemit të ri të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në vend, në pozitën e pronarit të aksioneve të shoqërisë ALBGAS.

Kjo vendimmarrje është përtej kompetencave administrative të shoqërisë pasi ka të bëjë me politikën bërjen e veprimtarisë tregtare.

3. Vështrim i Përgjithshëm mbi ALBGAS, licencim dhe aktivitete

Në sektorin e gazit natyror, gjatë vitit 2024, ERE ka miratuar disa akte nënligjore të cilat do të luajnë rol në zhvillimet e pritshme të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes, si dhe janë miratuar disa vendime.

Gjatë vitit 2024, për sektorin e gazit natyror, nga ana e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) janë miratur Vendimet si më poshtë:

Me vendimin nr. 59, datë 02.04.2024, MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 179, DATË 08.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR” ALBGAS SH.A.” , I NDRYSHUAR

Bordi i ERE -s vendosi mbi një ndryshim në vendimin e : Pika 5.2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar, bëhet si vijon: 5.2: Brenda datës 31.12.2024 shoqëria “ALBGAS” sh.a. duhet të depozitojë në ERE realizimin e ndryshimeve në nenet 11 dhe 46, pika 10 ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Me vendimin nr. 272, datë 10.12.2024, MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 179, DATË 08.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR” ALBGAS SH.A.” , I NDRYSHUAR

Bordi i ERE -s vendosi mbi një ndryshim në vendimin e : Pika 5.2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar, bëhet si vijon: 5.2 Brenda datës 31.12.2025 shoqëria “ALBGAS” sh.a. duhet të depozitojë në ERE realizimin e ndryshimeve në nenin 11 dhe nenin 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2024

Me vendimin nr. 277, datë 13.12.2024, MBISHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E PLANIT DHJETËVJEÇAR TË INVESTIMEVE NGA SHOQËRIA ALBGAZ SH.A.

Bordi i ERE -s vendosi mbi një ndryshim në vendimin e : Shtyrjen e vendimarrjes së bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria “Albgaz” sh.a., deri në muajin dhjetor të vitit 2025.

Me vendimin nr. 280, datë 16.12.2024, MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 206, DATË 16.12.2019 “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAZ” SH.A. PËR VITIN 2025”

Bordi i ERE -s vendosi mbi një ndryshim në vendimin e :

Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s për vitin 2025, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

4. Programi i Përputhshmërisë

Nga shqyrtimi dhe komunikimi me ALBGAZ për përmbushjen e detyrave sipas programit të përputhshmërisë, konstatohet se:

1. Ne faqen e internetit të ALBGAZ sh.a (www.albgaz.al) janë publikuar të gjitha raportet vjetore të Përputhshmërisë prej vitit 2019, detyrim ky që rrjedh nga pika 73 e Programit.

Gjithashtu ka dhe një menu të veçantë për të raportuar tek Zyrtari.

Se dyti, Shoqëria ALBGAZ nuk ka asnjë klient fundor apo ndonjë klient të cilit i jep akses në gazin LNG.

Së treti, ALBGHAZ dhe ERE janë në komunik të vazhdueshëm për plotësimin e dokumentave që kërkohen për licencin.

Së katërti, ALBGa po ndërmarr një sër projektesh për gazifikim të Shqipërisë. SProjekte që janë përfshirë tek raporti i tyre investimet 10 vjeçare.

Së fundmi, përsa i përket monitorimit të përputhshmërisë dhe përmbushjes së këtyre detyrimeve është bazuar në katër parimet themelore (**ndarja dhe pavarësia, aksesit dhe shpërdarja e informacionit, përjashtimi i sjelljes diskriminuese dhe zbatimi i rregullt i programit**) të programit të përputhshmërisë është miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (Bordi) me Vendim Nr. 171, Datë 16.08.2022 mbi “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAZ” sh.a”, shqyrtohet se si aktiviteti i ALBGAZ duhet të qeveriset sipas standarteve që përcakton legjislacioni në fuqi.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2024

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë.

Kërkesat dhe parimet e mëposhtme rregullatore duhet të konsiderohen prioritare për ALBGAZ, dhe çdo strukturë e saj është e detyruar të realizoj dhe kërkojë përputhshmërinë me këto kërkesa dhe parime.

A. Ndarja dhe pavarësia

1. Ndarja

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 “kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”**

- **ALBGAZ i plotëson kërkesat e programit** pasi zhvillon aktivitetin e saj të ndarë nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me Nenin 36 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror. Albgaz sh.a., në përmbushje të konstatimeve që i referohen pikës 5 dhe 6, të Kreut II, të Programit të Përputhshmërisë (Statusi ligjor dhe struktura e korporatës së OST) dhe të pikës 15, të Kreut III, që ka të bëjë me ndarjen e pronësisë dhe pavarësinë e OST, Albgaz Sh.a. i ka bërë me dije Entit Rregullator të Energjisë se ka marrë të gjitha masat dhe aktualisht jemi në proces konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 “kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”** ka siguruar dhe garantuar ndarjen e duhur të ALBGAZ, duke marrë masa që i njëjti person ose të njëjtët persona të emëruar, anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ALBGAZ të mos kenë të drejtë që njëkohësisht të ushtrojnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e subjektit që kryen veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror, si dhe të jenë anëtarët të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të e të gazit natyror dhe veprimtarinë e ALBGAZ ose rrjetit të transmetimit.

2. Pavarësia drejtuese

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 “kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”** duke marrë masa që për të arritur pavarësinë e drejtuesve. Për sa i përket pavarësisë së drejtuesve të ALBGAZ, të tillë si Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, Administratori, kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njësive strukturore), janë të pavarur nga kompanitë

vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj. Për këtë qëllim, janë zbatuar kërkesat e mëposhtme:

- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk janë të lidhur profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk kanë interes apo marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Pagat e drejtuesve në Albgaz sh.a. vendosen në bazë të elementëve të paracaktuar që kanë lidhje me performancën e Albgaz sh.a., siç specifikohet tek kontrata e punësimit dhe/ose tek udhëzimet e punësimit.
- Transferimi i drejtuesve të Albgaz sh.a. tek kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe anasjelltas, është parashikuar të bëhet sipas kushteve transparente të vendosura qartë tek Statuti i Albgaz sh.a. dhe do ndiqet rregullisht, dhe asnjë nga këto transferime nuk do mund të paracaktohen që në fillim.
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk kanë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe nuk kanë konflikte të mundshme interesi që kanë lidhje me këto aksione.

3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ ALBGAZ nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 “**kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024**”: **ALBGAZ ka pavarësi totale funksionale dhe Vendimarrëse.** ALBGAZ mbështetur në Ligjin nr.102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit është përgjegjës për dhënien aksesit për palët e treta, përfshirë mbledhjen e detyrimeve të aksesit dhe detyrimeve të kongestionit, për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe për të siguruar një mundësi afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, ALBGAZ është përgjegjëse për planifikimin (duke përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe autorizimin e infrastrukturës së re të gazit. ALBGAZ është e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të Ligjit 102/2015 dhe akteve të tjera ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetë-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë. ALBGAZ mban në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.

B. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese

Kushtet dhe procedurat përcaktohen në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Transmetimit të Gazit, për të parandaluar ndonjë trajtim diskriminues nga ana e ALBGAZ.

1. Aksesit në sistemin e transmetimit

përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGASZ ALBGASZ nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 **“kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”**: ALBGASZ i plotëson kërkesat e Programit duke marrë masa të sigurojë akses të barabartë dhe jo diskriminues. Në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” shoqëria Albgaz sh.a ka hartuar dhe dërguar për miratim “Programin e Përputhshmërisë” i cili është filtri/garancia e fundit për garantimin e zbatimit me përpikmëri të dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Albgaz sh.a. ka marrë të gjitha masat për të siguruar akses të barabartë dhe jo diskriminues në sistemin e transmetimit.
- Për sa i përket tarifës së transmetimit, shoqëria ALBGASZ me shkresën nr. 101/1 prot., datë 21.09.2022, ka kërkuar që për vitin 2024 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit. ERE me vendim nr. 326, datë 14.12.2022 mbi *“Lënie në fuqi të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGASZ për vitin 2024”* vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të tarifës dhe për vitin 2024. Bashkëlidhur shkresa 101/1 dhe vendimi nr. 326/2022

2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGASZ ALBGASZ nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 **“kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”**: ALBGASZ i plotëson kërkesat e programit. Për sa i takon konkurrencës dhe marrëdhënieve komerciale, përgjate vitit 2022 nuk është raportuar asnjë shkelje apo keqmenaxhim i veprimtarisë tregtare si në përgjithësi ashtu edhe lidhur me raste të vecanta. Aktivitetet e ALBGASZ nuk kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror
- Përgjatë vitit 2024 shoqëria ALBGASZ nuk ka nënshkruar dhe për rrjedhojë nuk ka njoftuar ERE për kontratë transmetimi.

3. Konflikti i interesit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGASZ ALBGASZ nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 **“kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”**: ALBGASZ i plotëson kërkesat e Programit nuk ka asnjë shkelje. Në lidhje me konfliktet e interesit, përgjatë vitit 2024, nuk është sinjalizuar asnjë shkelje apo abuzim

punonjësve të shoqërisë ALBGAS nga ana e Bilbilfryresit apo e ndonjë individi tjetër të brendshëm apo të jashtëm të shoqërisë.

C. Politika e informacionit të kompanisë ALBGAS

ALBGAS ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar informacionin, konfidencialitetin dhe transparencën ndaj publikut duke i ofruar akses të barabartë përdoruesve në të gjitha dokumentacionet që disponon pasi është e detyruar të publikojë në faqen zyrtare të korporatës, sipas kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e saj.

1. Sigurimi i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAS ALBGAS nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 “kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”:ALBGAS i plotëson kërkesat e Programit.

2. Konfidencialiteti i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAS nr. ALBGAS nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 “kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”:ALBGAS i plotëson kërkesat e Programit.

3. Informacioni publik

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAS nr. ALBGAS nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 “kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024”:ALBGAS i plotëson kërkesat e Programit.
- Shoqëria ALBGAS disponon faqen web www.albgaz.al, gjithashtu çdo kontratë transmetimi, kodi i rrjetit, tarifën e transmetimit etj, janë të miratuar nga ERE dhe të publikuar në faqen e saj web www.ere.gov.al), ku çdo operator i interesuar mund të kryejë kërkesën e saj për përdorimin e rrjetit të transmetimit të gazit natyror.

D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë

Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 171, datë 16.08.2022, është i krijuar i tillë që të ketë formën e një rregulloreje, apo udhëzimi me angazhime të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të ALBGAS, siç janë audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit si dhe palët e tjera të treta.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2024

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ ALBGAZ nr. 11/1 Prot datë, 21.3.2024 “**kthim përgjigje shkresa nr. 44/1 prot datë, 09.4.2024**”: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.**

- Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.102/2015 “ Për Sektorin e Gazit Natyror”, pikës 66 të Programit të Përputhshmërisë si dhe kontratës së lidhur midis ALBGAZ dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, shoqëria ALBGAZ ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar monitorimin e vazhdueshëm për zbatim siç duhet të Programit të Përputhshmërisë, i cili ka funksionuar në bazë dhe sipas kompetencave të dhëna nga ligji, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm nga secila drejtori dhe apo punonjës që ka mbuluar një sektor të caktuar. Zyrtari i Përputhshmërisë gjithashtu ka pasur aksesin në zyrat e shoqërisë ALBGAZ, tek i gjithë informacioni i nevojshëm që duhet për të kryer detyrat e tij.

PJESA E DYTË

4. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë

Në raportin e vitit 2024, ALBGAZ duhet të ketë parasysh rekomandimet e më poshtme për përmirësimin e tregut të gazit natyror.

1. Vlerësimi i rrjetit ekzistues të gazit në Shqipëri dhe dhënia e rekomandimeve për integrimin e tij të mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit.
2. Shqyrtimi i aplikimeve, analiza e kostove dhe miratimi i tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e gazit natyror për: Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
3. Shtimi i klientëve fundorë.
4. Prezantimi dhe informimi me stafin për Përputhshmërinë rregullisht.
5. Njoftimi dhe informimi i Zyrtarit për Mbledhjet e ALBGAZ.
6. Përmirësimi i Programit

PJESA E TRETË

6. Konkluzione

Në vitin 2024, që shënon vitin e shtatë të zbatimit të Programit të Përputhshmërisë, ALBGAZ ka vijuar përpjekjet e saj për të përmbushur detyrimet e pavarësisë si operator i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit. Në përputhje me procesin e liberalizimit të tregut të gazit dhe angazhimet e marra me certifikimin si operator i pavarur, shoqëria ka vazhduar të fokusohet në:

1. Sigurimin e shërbimeve thelbësore për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror;
2. Garantimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë për të gjithë përdoruesit e sistemit, duke respektuar kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Raporti i vitit 2024 nuk ka evidentuar shkelje të rëndësishme që mund të cenonin standardet e përputhshmërisë, përfshirë:

- Pavarësinë e operatorit të sistemit të transmetimit (OST) nga ndërmarrjet e integruara vertikalisht që merren me prodhimin dhe furnizimin e gazit;
- Konfidencialitetin e të dhënave dhe informacionit tregtar të ndjeshëm;
- Trajtimin e barabartë të të gjithë përdoruesve të rrjetit, duke garantuar qasje të drejtë në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes.

Një aspekt pozitiv është përmirësimi i sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së informacionit, duke minimizuar rreziqet që mund të ndikojnë në operacionet e brendshme të sistemit. Shoqëria ka treguar përkushtim në implementimin e masave parandaluese për të siguruar një funksionim të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

Bashkëpunimi i ngushtë mes organeve drejtuese, stafit dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë ka qenë një element kyç në ruajtjen e standardeve të kërkuara. Vazhdimi i këtij bashkëpunimi është thelbësor për:

- Parandalimin e sjelljeve diskriminuese ndaj përdoruesve të sistemit dhe ofruesve të shërbimeve të balancimit;
- Ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave tregtare konfidenciale;
- Sigurimin e pavarësisë së stafit drejtues dhe shmangien e konflikteve të interesit.

Për të forcuar më tej përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator, mbetet e domosdoshme që Zyrtari i Përputhshmërisë të jetë i përfshirë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse dhe të informohet në mënyrë të vazhdueshme mbi çështjet që mund të ndikojnë parimet bazë të OST-së. Përmirësimi i mëtejshëm i ndërgjegjësimit të stafit mbi detyrimet e përputhshmërisë dhe krijimi i një kulture korporative që i kushton rëndësi respektimit të rregullave mbetet një prioritet për ALBGAZ.

Tiranë, 28.3.2024

Elvis Ponari, MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAZ Sh.a